VENDIM
Nr. 509, datë 1.8.2024

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 600, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PRONËSINË E RRUGËVE SHTETËRORE DHE KALIMET E PRONËSISË NDËRMJET ENTEVE PRONARE TË RRUGËVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", dhe të nenit 4, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Pavarësisht transferimit të inventarit të rrugëve ndërmjet enteve pronare, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi, kontratat për investime dhe mirëmbajtje të lidhura para hyrjes në fuqi të vendimit nr. 234, datë 17.4.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, 'Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve'", i vazhdojnë efektet deri në përfundim të afatit të tyre.".

2. Ngarkohet Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama